KUJDES! MOS DËMTO BARKODIN

BARKODI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

# OLIMPIADA KOMBËTARE E HISTORISË
# NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

## Faza e tretë

Viti shkollor 2021-2022 — 16 prill 2022

## Udhëzime për nxënësin:

- Olimpiada fillon në orën 10.00 dhe mbaron në orën 13.00.
- Testi përmban 5 **pyetje.**
- Për secilën pyetje është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

## Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

| Pyetja | 1 | 2 | 3 | 4a | 4b | 4c | 5a | 5b | 5c |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 8 pikë | 8 pikë | 10 pikë | 4 pikë | 4 pikë | 4 pikë | 4 pikë | 4 pikë | 4 pikë |
| Pikët e fituara | | | | | | | | | |

Totali i pikëve të fituara

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.……………………………………….

2. ……………………………………….

1. Analizoni se si ngjarjet e Revolucionit Francez dhe periudhës së Napoleonit (1789 – 1815) i shtynë njerëzit të vënë në pikëpyetje idetë iluministe mbi shoqërinë, politikën dhe natyrën njerëzore. 8 pikë

2. “Martin Luther ishte në të njëjtën kohë një revolucionar dhe një konservator”. Analizoni dhe vlerësoni këtë thënie në lidhje me problemet politiko-shoqërore të kohës. 8 pikë

3. “Nga Stalingradi në Balltik deri në Trieste në Adriatik, një perde e hekurt ka zbritur në të gjithë kontinentin. Pas kësaj perdeje qëndrojnë të gjitha kryeqytetet e shteteve më të lashta të Evropës Qendrore dhe Lindore. Të gjitha këto qytetet dhe popullsia e tyre shtrihen në sferën sovjetike dhe i nënshtrohen në një masë të madhë gjithnjë në rritje kontrollit nga Moska”.

   Duke u nisur nga fjalimi i Uinston Çurçill në mars 1946, jepni nje panoramë të plotë të Luftës së Ftohtë, duke analizuar aktorët dhe momentet kyçe të saj. 10 pikë

4. Diskutoni ndërthurjen mes politikës dhe fesë duke marrë në analizë luftrat fetare si më poshtë:

a) Luftrat fetare në Francë: 4 pikë

b) Lufta Civile në Angli: 4 pikë

c) Lufta Tridhjetëvjeçare në Evropë: 4 pikë

5. Nga krijimi i shtetit shqiptar deri në rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri u miratuan ligjet themeltare që përcaktonin parimet e përgjithshme të organizimit të shtetit.

a) Duke krahasuar Statutin Organik të Shqipërisë dhe Statutin e Lushnjës, shkruani dy të përbashkëta dhe dy të veçanta midis tyre. 4 pikë

Të përbashkëtat:

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

Të veçantat:

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

b) Duke krahasuar Statutin Themeltar të Republikës së Shqipërisë me Statutin Themeltar të Mbretërisë së Shqipërisë, nxirrni dy të përbashkëta dhe dy të veçanta. 4 pikë

Të përbashkëtat:

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

Të veçantat:

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

c) Gjykoni mbi ndryshimet mes kushtetutës së vitit 1946 dhe asaj të vitit 1976 në planin politik, ekonomik, fetar dhe shoqëror. 4 pikë

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________